



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 pika (d), lidhur me nenin 40 paragrafi 2, pika (c) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 45 paragrafi 4, lidhur me nenin 46 paragrafi 2, të Ligjit Nr-03/L-048, për menaxhimin e financave publike të përgjithshme, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 27/2008”, e konformnenit 29 dhe 54 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, ----- miratoi këtë;

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim miratohet Raporti financiar i ekzekutimit dhe administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2023.

Neni 2

Pjesë përbërës e këtij vendimi është edhe Raporti financiar i ekzekutimit dhe i administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2023, me numër të protokollit 01-Nr-052-4497 të datës 15.01.2024 i hartuar nga Drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet e Komunës së Suharekës.

Neni 3

Për zbatimin-implementimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoret e Drejtorive dhe Kryetari i Komunës së Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI